



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 356/3 Prot

Tiranë, më 08.04.2021

V E N D I M

Nr.35, datë 08.04.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e pjesshëm të ligjshmërisë së procesit të ristrukturimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, pranë Ministrisë së Brendshme, filluar në bazë të informacionit të përcjellë me kërkesën nr. 356 prot., datë 26.2.2021, prej nëpunësit ***.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procesit të verifikimit të informacionit të marrë nga kërkesa e nëpunësit *****,

Vërejt se:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 356 prot., datë 26.2.2021, nëpunësi ***** ka parashtruar pretendimin se, transferimi i tij për shkak të ristrukturimit të institucionit, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Politikave të Decentralizimit*”, në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive për Çështjet Vendore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave për Çështjet Vendore dhe Prefekturat, në Ministrinë e Brendshme, është i padrejtë, për tre arsye të përmbledhura prej tij: *së pari*, ai është i vetmi nëpunës i transferuar pa të drejtë, jashtë sektorit, drejtorisë apo drejtorisë së përgjithshme ku ai ishte i emëruar më parë; *së dyti*, para nisjes së procesit të ristrukturimit nuk ka patur ndryshim të misionit apo të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon gjendja civile; *së treti*, kërkesat e veçanta për pozicionet e punës të mbartura në strukturën e re, nuk kanë pësuar asnjë ndryshim.

Me pretendimet si më sipër, ai i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse dhe Komisionerit, duke kërkuar që lidhur me transferimin e tij, të verifikohet mënyra e zbatimit të metodologjisë së vlerësimit të nëpunësve, në bazë të sistemit të pikëzimit, parashikuar në ankesin nr. 1, që i bashkëlidhet si pjesë përbërëse udhëzimit të DAP nr. 1, datë 1.3.2016, i ndryshuar.

Në kuadër të verifikimit të këtyre pretendimeve, u kërkuua dokumentacioni përkatës në Ministrinë e Brendshme, nga shqyrtimi i të cilit rezulton e vërtetuar sa më poshtë:

Nëpunësi ******, me aktin nr. 5063 prot., datë 19.8.2016, të Departamentit të Administratës Publike, nëpërmjet procedurës së konkurrimit për lëvizje paralele, është emëruar në pozicionin *“Specialist në Sektorin e Mbikëqyrjes së Procedurave”*, në Drejtorinë e Dokumentacionit dhe Procedurave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, në Ministrinë e Brendshme.

Shkaku i mosmarrëveshjes lidhet me implementimin e urdhërit nr. 16, datë 13.1.2021, të Kryeministrit *“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Brendshme”*, me të cilin është miratuar struktura dhe organika e Ministrisë së Brendshme (pjesë e të cilës është dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile). Pas daljes së urdhërit të mësipërm, njësia e burimeve njerëzore e institucionit, në zbatim të parashikimeve të pikës 15, të kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*, nëpërmjet email zyrtar datë 15.1.2021, ka njoftuar të gjithë punonjësit e institucionit për miratimin e strukturës së re dhe fillimin e veprimeve për zbatimin e saj.

Ndërkohë, me aktin nr. 10 (387/1 prot.), datë 18.1.2021, të njësisë përgjegjëse (DAP), është ngritur Komisioni i Ristrukturimit, i cili në përfundim të procesit të shqyrtimit dhe analizës së mundësisë të sistemimit të nëpunësve në vendet e lira ekzistuese, të krijuara rishtas apo të ristrukturuara, për nëpunësin ******, ka propozuar transferimin e tij nga pozicioni *“Specialist në Sektorin e Mbikëqyrjes së Procedurave”*, në Drejtorinë e Dokumentacionit dhe Procedurave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, në pozicionin *“Specialist në Sektorin e Politikave të Decentralizimit”*, në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive për Çështjet Vendore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave për Çështjet Vendore dhe Prefekturat, në Ministrinë e Brendshme. (Vendim nr. 2007/17 prot., datë 15.2.2021, i Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme, për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, pika 78).

Këtë propozim, e ka miratuar pa vërejtje edhe njësia përgjegjëse, e cila nëpërmjet aktit nr. 1320/1 prot., datë 19.2.2021 (pika 78 e tij) dhe aktit individual nr. 1320/66 prot., datë 19.2.2021, ka vendosur transferimin e përhershëm të nëpunësit ******, në pozicionin *“Specialist në Sektorin e Politikave të Decentralizimit”*, në Drejtorinë e Politikave dhe

Strategjive për Çështjet Vendore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave për Çështjet Vendore dhe Prefekturat, në Ministrinë e Brendshme.

Kërkuesi e konsideron këtë transferim të padrejtë, me pretendimin se, ai i plotëson më mirë se të tjerët, kërkesat e veçanta përkundrejt pozicioneve të miratuara në sektorin e ri, të cilit i kaluan funksionet e sektorit të mëparshëm dhe se në bazë të sistemit të vlerësimit të kriterëve kyç në procesin e ristrukturimit, siç janë arsimi, përvoja në pozicionin aktual, si dhe përvoja në shërbimin civil, ai vlerësohet me më shumë pikë se nëpunësit e tjerë të sektorit të tij dhe për këtë arsye, ka paraqitur ankesën nr. 2007/113 prot., datë 25.2.2021, pranë njësisë përgjegjëse.

Konstatohet se, Departamenti i Administratës Publike, në përgjigje të ankesës së mësipërme, ka sqaruar se transferimi i tij për shkak të ristrukturimit është kryer konform ligjit, pasi: drejtorja ku ai ishte i punësuar “*Drejtorja e Dokumentacionit dhe Procedurave*”, në strukturën e re, ka ndryshuar emërtesën duke u bërë “*Drejtorja e Hartimit të Procedurave dhe Dokumenteve Biometrike*”; kjo drejtori ka shkurtim të vendeve të punës dhe se kriteri arsimor i përcaktuar për pozicionet specialist nuk përputhet me arsimin që zotëron ankuesi e për rrjedhojë ai nuk është përfshirë në vlerësimin e kryer nga Komisioni i Ristrukturimit (*shkresa e DAP, nr. 1320/94 prot., datë 4.3.2021*).

Por ky konkluzion në të cilin ka arritur njësisë përgjegjëse, nuk gjen mbështetje të plotë në dokumentet shkresore të cilat materializojnë realizimin e procedurës së ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme.

Më konkretisht, sipas strukturës së mëparshme ankuesi ishte i punësuar në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Mbikëqyrjes së Procedurave*”, në Drejtorinë e Dokumentacionit dhe Procedurave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, të Ministrisë së Brendshme. Komisioni i Ristrukturimit i ngritur në këtë rast, pasi ka shqyrtuar dokumentacionin e administruar lidhur me procesin e ristrukturimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, ka konstatuar se funksionet e ish Drejtorisë së Dokumentacionit dhe Procedurave (*drejtorja ku ishte i emëruar ankuesi*), janë ndarë ndërmjet Drejtorisë së Hartimit të Procedurave dhe Dokumenteve Biometrike dhe Drejtorisë së Administrimit të Regjistrave dhe Kontrollit të Shërbimeve.

Konkretisht, “*Spektori i Mbikëqyrjes së Procedurave*”, i ish Drejtorisë së Dokumentacionit dhe Procedurave, ka kaluar si me funksion ashtu dhe pothuaj, me krejt përbërjen e mëparshme të personelit, në Sektorin e Kontrollit të Shërbimit të Gjendjes Civile, në Drejtorinë e Administrimit të Regjistrave dhe Kontrollit të Shërbimeve.

Pra, Komisioni i Ristrukturimit ka arritur në përfundimin se funksioni i mbikëqyrjes së procedurave, në strukturën e re, i ka kaluar Sektorit të Kontrollit të Shërbimit të Gjendjes

Civile, prandaj kjo duhej të ishte baza mbi të cilën do të ngrihej i gjithë arsyetimi për përzgjedhjen dhe sistemimin e nëpunësve në pozicionet e mbetura apo të ristrukturuara.

Ndryshe nga sa më sipër, konstatohet se njësia përgjegjëse, në përmbajtjen e shkresës nr. 1320/94, datë 4.3.2021, me të cilën i është kthyer përgjigje ankesës së nëpunësit *****, arsyeton se është i pamundur sistemimi i tij në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, pasi ish “*Drejtoria e Dokumentacionit dhe Procedurave*”, jo vetëm ka ndryshuar emërtim duke u quajtur “*Drejtoria e Hartimit të Procedurave dhe Dokumenteve Biometrike*”, por ka pësuar edhe shkurtime të numrit të pozicioneve, duke kaluar nga 11 punonjës, në 7 punonjës gjithsej. Për më tepër, në këtë shkresë thuhet se ka edhe ndryshim të përshkrimeve të punës dhe të kërkesave të veçanta për pozicionin e punës “*Specialist në Sektorin e Procedurave*”, duke kërkuar arsim në fushën e shkencave juridike, apo shkencave politike.

Ky arsyetim i njësisë përgjegjëse, nuk përputhet me konstatimin e Komisionit të Ristrukturimit, bërë në vendimin e tij, prandaj lind e nevojshme që të bëhet një analizë dhe rivlerësim më i plotë i gjendjes së organizimit dhe kompetencave të organizmave të krijuara me strukturën e re. Mënyra si ka vepruar Komisioni i Ristrukturimit dhe propozimet e bëra për ripozicionimin e punonjësve të ish Sektorit të Mbikëqyrjes së Procedurave, të ish Drejtorisë së Dokumentacionit dhe Procedurave, në Sektorin e Kontrollit të Shërbimit të Gjendjes Civile, në Drejtorinë e Administrimit të Regjistrave dhe Kontrollit të Shërbimeve, flasin për faktin se funksionet e sektorit të mëparshëm të mbikëqyrjes së procedurave, kanë kaluar pikërisht në Sektorin e Kontrollit të Shërbimit të Gjendjes Civile dhe jo në Sektorin e Procedurave të Drejtorisë së Hartimit të Procedurave dhe Dokumenteve Biometrike, pavarësisht ngjashmërisë në emërtime. Për këtë flet edhe fakti, që pothuaj të gjithë punonjësit e mëparshëm të ish Sektorit të Mbikëqyrjes së Procedurave, janë riemëruar në Sektorin e Kontrollit të Shërbimit të Gjendjes Civile.

Bazuar në pikën 3, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe pikën 18, të kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, Komisioni i ristrukturimit në kryerjen e detyrës së tij, duhej të ishte bazuar në kriteret e posaçme të vendeve të lira dhe të dhënat e nëpunësve civilë, vendet e të cilëve preken si pasojë e ristrukturimit.

Nga analiza e materialeve shkresore të dërguara nga institucioni si dhe materialeve bashkëlidhur ankesës të paraqitur nga nëpunësi, rezulton se ish “*Spektori i Mbikëqyrjes së Procedurave*”, kishte 3 specialistë me kërkesë arsim “*Master Profesional*” në shkencë shoqërore + 1 pozicion specialist IT. Ndërsa, sektori i ri që ka marrë kompetencat e tij (*Spektori i Kontrollit të Shërbimit të Gjendjes Civile, pjesë e Drejtorisë së Administrimit të Regjistrave dhe Kontrollit të Shërbimeve*), ka 2 pozicione specialist, me kërkesë arsim “*Master Profesional*” në shkencë shoqërore, edhe diploma e nivelit “*Bachelor*”, të jetë në

të njëjtën fushë. Pra, është shkurtuar një pozicion specialist për IT dhe një pozicion specialist me kërkesa specifike arsim “*Master Profesional*” në shkencë shoqërore, ndërsa 2 pozicionet e tjera janë ruajtur pa u bërë asnjë ndryshim në kërkesat specifike për arsimin apo kriteret e tjera.

Bazuar në listëprezencën e muajit shkurt 2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, konstatohet se në momentin e miratimit të strukturës së re, në 3 pozicionet e punës me kërkesa specifike për arsimin “*Master Profesional*” në shkencë shoqërore, ishin të punësuar nëpunësit *****, *****, dhe *****, me të dhëna individuale si më poshtë:

*****:

Arsimi, Diplomë Nr. 8441, Universiteti i Tiranës, vitet 1995-2004, kursin e plotë në Fakultetin e Drejtësisë, Dega Drejtësi, i jepet titulli “*Jurist*”.

Diplomë nr. 1083, Instituti i Lartë Pedagogjik Gjirokastrë, vitet 1981-1984, Dega e përgatitjes së mësuesve për klasat 1-4 të shkollës 8 vjecare.

Përvojë pune në shërbimin civil, 1.1.2006-4.11.2013, Drejtor në Drejtorinë e Dokumentacionit dhe Procedurave në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile; 4.11.2013-15.2.2021, përvojë pune në pozicionin që mbante në strukturën e vjetër.

*****:

Arsimi, Diplomë nr. 1443, të Universitetit “*Eqerem Çabej*”, të Gjirokastrës, vitet 1998-2004, kursin e plotë të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, i jepet titulli “*Mësuese për edukimin pedagogjik parashkollor*”.

Përvojë pune në shërbimin civil, 30.12.2015-15.2.2021, përvojë pune në pozicionin që mbante në strukturën e vjetër. (Në dt. 30.12.2015, emërohet për herë të parë në shërbimin civil).

*****:

Arsimi, Diplomë Nr. 356, Universiteti i Tiranës, vitet 1997-2001, kursin e plotë të Fakultetit të Shkencave Sociale, Dega Punë Sociale, i jepet titulli “*Punonjës Social*”.

Përvojë pune në shërbimin civil, 22.8.2016-15.2.2021, përvojë pune në pozicionin që mbante në strukturën e vjetër; 8.11.2010-22.8.2016, nëpunës civil, specialist në Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim; 22.5.2003-1.11.2007, doganier në Doganën Kukës, DPD.

Në rrethanat kur sipas strukturës së re sektori ka vetëm 2 pozicione pune (*një më pak se struktura e mëparshme*), ndërkohë që duhet të sistemoheshin 3 nëpunës civilë ekzistues, është e detyrueshme të bëhet një analizë dhe vlerësim i hollësishëm i të dhënave dhe cilësive

personale të nëpunësve ekzistues, në mënyrë që të arrihet në konkluzione sa më objektive, duke ruajtur parimet e mosdiskriminimit, meritës, transparencës, qëndrueshmërisë në detyrë dhe vazhdimësisë në shërbimin civil.

Për të realizuar këtë detyrë, bazuar në dy kolonat kryesore mbi të cilën veprohet gjatë kryerjes së procesit të ristrukturimit, kriteret e posaçme të vendeve të lira dhe të dhënat e nëpunësve civilë, lind e nevojshme të verifikohet saktësia e konkluzioneve të Komisionit të Ristrukturimit, si në drejtim të faktit se cili nga nëpunësit ka cilësi personale më të mira dhe nisur nga sistemi i pikëzimit, cili prej nëpunësve ekzistues është më i përshtatshëm për tu sistemuar në këto pozicione.

Kështu, duke bërë vlerësimin e përputhshmërisë së llojit të arsimit të kryer prej nëpunësve në fjalë, me kërkesat e vendeve të punës, konstatohet se arsimimi i nëpunësit ***** me Diplomë të Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Dega Punë Sociale, me titull *“Punonjës Social”*, është më i përshtatshëm me vendin e punës se arsimimi që zotëron nëpunësja ***** me Diplomë të Universitetit *“Egerem Çabej”*, Fakulteti i Shkencave të Edukimit, titulli *“Mësuese për edukimin pedagogjik parashkollor”*. Gjithashtu, nëpunësi ***** e ka përvojën në shërbimin civil mbi 15 vjet, ndërsa nëpunësja ***** mbi 5 vjet. Nëse Komisioni i Ristrukturimit, do të kishte bërë një punë të kujdesshme me sistemin e pikëzimit dhe një vlerësim më objektiv të këtyre kriterëve, do të kishte arritur në përfundimin se në pozicionin e mbetur pas ristrukturimit, duhej të caktohej nëpunësi ***** i cili ka cilësi më të përshtatshme për vendin e punës.

Në vijim të këtij arsyetimi, njësia përgjegjëse, përfaqësuesi i të cilës është edhe drejtues i Komisionit të Ristrukturimit, në zbatim të procedurave të parashikuara në pikat 17 e 18, të udhëzimit të DAP nr. 1, datë 1.3.2016, *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”*, me rastin e shqyrtimit të ankesës së nëpunësit ***** duhet të kishte urdhëruar kthimin e akteve Komisionit të Ristrukturimit, me qëllim që, bazuar në hapat proceduralë të parashikuar në pikën 8, të udhëzimit të DAP nr. 1, datë 1.3.2016, si dhe metodologjinë e vlerësimit dhe sistemin e pikëzimit të shpjeguar në aneksin nr. 1, që i bashkëlidhet si pjesë përbërëse këtij udhëzimi, të përsëritej vlerësimi, duke krijuar mundësinë e sistemimit në pozicionet e mbetura në Sektorin e Kontrollit të Shërbimit të Gjendjes Civile, të nëpunësve më të përshtatshëm të ish Sektorit e Mbikëqyrjes së Procedurave.

Procesi i ristrukturimit, është një proces që kryhet në bazë të rregullave të mirpërcaktuara nga legjislacioni i shërbimit civil dhe shërben për riorganizimin e institucionit pas shkurtimit apo shtimit të vendeve të punës, por në asnjë rast, pavarësisht qëllimit që ka organi drejtues, ai nuk mund të shërbejë si shkak për lëvizjen e pambështetur në ligj, të punonjësve.

Bazuar në gjithë sa më sipër, arrihet në konkluzionin se, në veprimet e kryera nga Komisioni i Ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme dhe Departamenti i Administratës

Publike, për transferimin e përhershëm të nëpunësve *****, ***** dhe *****, nuk janë respektuar si duhet kërkesat e procesit të ristrukturimit. Për këtë arsye, bazuar në pikën “b”, të nenit 109, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, aktet e dala në këtë proces vlerësohen si akte që vijnë në kundërshtim me ligjin dhe si të tillë, bazuar në nenin 113, të ligjit në fjalë, duhet të anulohen nga vetë organi publik, duke urdhëruar Komisionin e Ristrukturimit që të rishqyrtojë dhe rivlerësojë sistemin në pozicionet e mbetura pas ristrukturimit, të nëpunësve që i plotësojnë më mirë kërkesat e pozicioneve të punës dhe që kanë grumbulluar më shumë pikë në vlerësimin përfundimtar, pas aplikimit të sistemit të pikëzimit.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të neneve 109/d, 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

Për rregullimin e situatës së ligjshmërisë, në zbatim të kërkesave të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar e të neneve 109/b, 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, të kërkoj nga organi publik Departamenti i Administratës Publike, që të anulojë pjesërisht aktin nr. 1320/1 prot, datë 19.2.2021, “Mbi transferimin e përhershëm të nëpunësve në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme”, në lidhje me transferimin e nëpunësve *****, ***** dhe *****, në kuadër të ristrukturimit, duke vepruar si më poshtë:

- Të anulojë pikën 76, të aktit nr. 1320/1 prot, datë 19.02.2021, ku urdhërohet transferimi i përhershëm i punonjësit *****, në pozicionin Specialist në Sektorin e Kontrollit të Shërbimit të Gjendjes Civile, në Drejtorinë e Administrimit të Regjistrave dhe Kontrollit të Shërbimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, në Ministrinë e Brendshme.
- Të anulojë pikën 77, të aktit nr. 1320/1 prot, datë 19.02.2021, ku urdhërohet transferimi i përhershëm i punonjësit *****, në pozicionin Specialist në Sektorin e Kontrollit të Shërbimit të Gjendjes Civile, në Drejtorinë e Administrimit të Regjistrave dhe Kontrollit të Shërbimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, në Ministrinë e Brendshme.
- Të anulojë pikën 78, të aktit nr. 1320/1 prot, datë 19.02.2021, ku urdhërohet transferimi i përhershëm i punonjësit *****, në pozicionin Specialist në Sektorin e Politikave të

Decentralizimit, në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive për Çështjet Vendore, në Drejtorinë e Përgjithshme për Politikën e Çështjeve Vendore dhe Prefekturat, në Ministrinë e Brendshme.

- Të kërkohet nga ana e njësisë përgjegjëse DAP, që të kthejë për rishikim të pjesshëm propozimin e Komisionit të Ristrukturimit (*Vendim nr. 2007/17 prot., datë 15.2.2021 i Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme, për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, të përmendur në pikat 76, 77 e 78*).
- Njësia përgjegjëse të krijojë të gjitha kushtet e të ndjekë ecurinë e procesit administrativ për zbatimin e detyrave të mësipërme, duke i kërkuar Komisionit të Ristrukturimit që vendimi propozues për transferimin e nëpunësve të shoqërohet me praktikën mbi bazën e të cilit është marrë vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha